

VENDIM
Nr. 128, datë 22.2.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.7, DATË 11.1.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR VITIN 2017 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr.130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.7, datë 11.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet “2 270 veta”.

2. Në pikën 4, pas fjalëve “... si dhe mësuesit në dispozicion në arsimin parauniversitar dhe arsimin profesional ...” shtohen “... dhe pedagogë të jashtëm/trajnerë të angazhuar në formimin profesional të magjistratëve ...”.

3. Në lidhjen nr.1, përmendur në pikën 1 të vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjet e mëposhtme shtohet nëndarja, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij:

i) “Gr.4, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”;

ii) “Gr.5, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave”;

iii) “Gr.10, Ministria e Financave”;

iv) “Gr.14, Ministria e Drejtësisë”;

v) “Gr.25, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”;

vi) “Gr.28, Prokuroria e Përgjithshme”;

vii) “Gr.29, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor”.

b) Periudha kohore për emërtesat e mëposhtme bëhet 6-mujore:

i) “specialist” në ndarjen “Gr.93, Ministria e Industrisë dhe Energjisë”;

ii) “teknik”, “hidraulik”, “elektricitet” dhe “ndihmëskuzhinier” në ndarjen “Gr.16, Ministria e Punëve të Brendshme”.

b) Kohëzgjatja ditore për emërtesat e mëposhtme bëhet 6 orë/ditë:

i) “Sanitar” në aparatin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes;

ii) “Specialist” tek Avokati i Popullit;

iii) për punonjësit e nëndarjes “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”.

c) Emërtesa “punonjës mirëmbajtjeje”, përmendur në nëndarjen “Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve” bëhet “punonjës shërbimi” dhe nëndarja “laboratori doganor” bëhet “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave”.

4. Për arkivistët e kontraktuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të paraqitet në Ministrinë e Financave përshkrimi i punës së punonjësve të sipërpërmendur, duke pasqyruar normën ditore të përpunimit të dokumentacionit arkivor, përshkrim i cili paraprakisht të jetë dakordësuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave. Për mjekët e kontraktuar nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, gjithashtu, të paraqitet përshkrimi i punës së tyre, përshkrim i cili paraprakisht të jetë dakordësuar me Ministrinë e Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Tabela

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
04	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	2			
	<i>Aparati</i>	1	Specialist	6 orë/ditë	Vjetore
	<i>Ajencia Kombëtare e Turizmit</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	6- muaj
05	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	1			
	<i>Ajencia Kombëtare e Duhan Cigareve</i>	1	12 punëtorë fushe		vjetor -sipas preventivit
06	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	4			
	<i>Organi Kombëtar Investigimit të Aksidenteve Ajrore</i>	1	Specialist IT	8 orë/ditë	6- muaj
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	2	Specialist arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Teknik	6 orë/ditë	vjetore
10	Ministria e Financave	3			
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	1	Specialist	8 orë/ditë	6- muaj
	<i>Aparati i Ministrisë</i>	2	Sanitar	6 orë/ditë	5- muaj
14	Ministria e Drejtësisë	4			
	<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor</i>	1	Ftues	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor</i>	1	Punonjës arkivi	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor</i>	1	Sanitar	6 orë/ditë	vjetore
	<i>Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor</i>	1	Mirëmbajtës	6 orë/ditë	vjetore
16	Ministria e Punëve të Brendshme	3			
	<i>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit</i>	3	Teknik	8 orë/ditë	6- muaj
25	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	5			
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	2	Mjek i Përgjithshëm	8 orë / ditë	6- muaj
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror	3	Specialistë	8 orë / ditë	6- muaj
28	Prokuroria e Përgjithshme	1			
	Prokuroria e Rrethit Tiranë	1	Punonjës arkivi	8 orë / ditë	6- muaj
29	Zyra Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	22			
	<i>Gjykatat e Apelit Tiranë / Kolegji Zgjedhor</i>	3	Sekretare gjyqësore	8 orë / ditë	6 muaj
	<i>Gjykata Administrative Apeli Tiranë</i>	6	Sekretare gjyqësore	8 orë / ditë	6 muaj
	<i>Gjykatat e Rretheve /Apeli Gjyqësore, /Gjykata Administrative</i>	12	Punonjës arkivi	8 orë / ditë	6 muaj
	<i>Gjykatat e Apelit Shkodër</i>	1	Nëpunës gjyqësor	4 orë / ditë	Vjetore
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	45			

